



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministririt / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, dt. 21 tetor 2010), nenit 12 të Ligjit për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, nenit 12 paragrafi 2.2 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr. 17, dt. 16 shtator 2011), si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt. 22.03.2011), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur

Numër: 11 / 2011

Datë: 30.12.2011

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim përcaktimin e participimit të vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur .
2. Vijuesi duhet të participoj, për të krijuar dhe siguruar kushte normale, për gjetjen e mësimdhënësve adekuat, lokaleve dhe mjeteve për zhvillimin e mësimin, pagesës së profesionistëve për mbajtjen e mësimin praktik, pagesës së komisioneve, të certifikatave, dëftesave si dhe diplomave për përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur si dhe për çështje të tjera për realizimin e programit të arsimit dhe aftësimin për të rritur.

Neni 2

Pagesa

1. Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur do të jetë:
 - 1.1. Për regjistrim të vitit (për një klasë 100€)..... 100€,
 - 1.2. Per praktik profesionale 50€,
 - 1.3. Provimi diferencial 10€,
 - 1.4. Për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën..... 30€,
 - 1.5. Për diplomë të përfundimit të shkollimit.....20€.

Neni 3

Pagesa bëhet ne xhirollogarin perkatese te institucionit permes bankes.

Neni 4

Mjetet e grumbulluara nga këto pagesa shfrytëzohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Pagesa e vijuesve për punën praktike

1. Vijuesit paguajnë shpenzimet materiale (reale) për provimin përfundimtar të klasë ose shkollimit në shkollën e mesme profesionale të punës praktike.
2. Shpenzimet materiale përfshijnë materialet të cilat shfrytëzohen për përgatitjen e punimit praktik të vijuesit.
3. Vendimin me specifikacionin e çmimeve e propozon shkolla, por e miraton DKA.

Neni 6

Dokumentacioni

Shkolla mban dokumentacionin dhe evidencën e rregullt për këtë lloj arsimimi dhe aftësimi për të gjithë kandidatët e paraqitur.

Neni 7

Raportimi

1. Shkolla është e obliguar që t'i raportoj DKA-së për secilin afat.
2. DKA-të janë të obliguara që për çdo vit shkollor t'i raportojnë MASHT-it për përfshirjen e kandidatëve në arsimin dhe aftësimin për të rritur.

Neni 8
Mbikëqyrja

MASHT në bashkëpunim me DKA-të mbikëqyrë dhe rregullon procesin e arsimit dhe aftësimin për të rritur .

Neni 9
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet udhëzimi administrativ nr. 41/2006, datë 23.11.2006.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Prof. Dr. Ramë Buja, ministër

